



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Tiranë më, 06.03.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË
MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA), PËR PROJEKTIN
“SIGURIA E DIGAVE”, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.9965, DATË 24.7.2008”**

- **Hyrje**

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqatës ndërkombëtare për zhvillim (IDA), për projektin “Siguria e Digave”, të ratifikuar me ligjin Nr 9965, datë 24.07.2008” në mbledhjen e datës 6 mars 2019.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë.

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

- **Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit**

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit për projektin “Siguria e digave”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008. Kjo marrëveshje synon të kontribuojë në sigurinë e digave më të mëdha hidro-elektrike mbi kaskadat

e lumenjve Drin dhe Mat në territorin e Përfituesit; dhe të përmirësojë efikasitetin operativ të këtyre digave hidro-elektrike dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë e furnizimit me energji në tregun rajonal.

Projekti përbën fazën e pestë të Programit, dhe përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Investimet infrastrukturore të sigurisë së digave, përmes ofrimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve për masat riparuese të digave me përparësi shumë të lartë, për basenet dhe mbi lumenjtë Drin dhe Mat, në digën e Fierzës, në degën e Vaut të Dejës dhe në hidrocentralin e Komanit;

Pjesa 2: Asistencë teknike dhe trajnim për sigurinë e digave përmes ofrimit të shërbimeve dhe trajnimit për EZP-në për të zbatuar një qasje të integruar të administrimit të burimeve ujore për administrimin e baseneve të lumenjve si dhe për optimizimin e shpërndarjes së energjisë dhe administrimin e burimeve ujore.

Projektligji vjen pas miratimit në parim të letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas me vendimin e Këshilli të Ministrave nr. 608 datë 17.10.2018, në respektim të nenit 10 të ligjit 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Ndryshimet e propozuara nuk prekin thelbin e marrëveshjes së miratuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008 dhe nuk shtojnë vlerën e huasë e cila mbetet në masën 21, 700, 000 SDR, por mundësojnë që:

- Në skedulën 2, seksioni IV, shkronja “A2” “Tërheqja e shumës së financimit”, në tabelën sipas këtij seksioni, bëhet një rialokim i shumës brenda kategorive ekzistuese. Konkretisht, kategoria (2) “Shërbime të Konsulentëve dhe Trajnime përveç pjesëve 2.1 dhe 2.4 të Projektit” nga 3,650,000 SDR bëhet 5,000,000 SDR, ndërsa kategoria (3) “Shërbimet e Konsulentëve të Zhvillimit të Hidrocentraleve dhe menaxhimit të Ujit për pjesët 2.1 dhe 2.4 të Projektit”, nga 3,500,000 SDR, bëhet 2,150,000 SDR.

Ky rialokim konsiston në rritjen e shumës brenda kategorisë 2 “shërbimet e konsulentëve” për supervizionin shtesë të punimeve rehabilituese elektromekanike të agregateve në HEC-in Koman.

Duhet të sqarohet fakti se, kontrata me konsulentin për projektin e sigurisë digave është e tipit “*Time base contract*” pra nuk është kontratë me çmim fiks. Për rrjedhojë sa herë që evidentohen aktivitete shtesë në këtë projekt nevojitet edhe amendimi i kontratës së konsulentit;

Aktualisht fondet të cilat kalojnë nga kategoria 3 në kategorinë 2 me qëllim mbulimin e kostove për supervizionin e punimeve dhe financimin e panelit të pavarur të ekspertëve për projektin e sigurisë së digave, janë fonde të lira të paangazhuara çfarë do të thotë se nuk ndikojnë në ecurinë e projektit.

Gjithashtu, për shkak se kryerja e këtyre punimeve shtesë të sipërcituara, kërkon kohë të realizohet, propozohet që në seksionin IV, shkronja “B.2”, data e mbylljes të shtyhet deri më 31 dhjetor 2020. Data aktuale e mbylljes së punimeve është 30 qershor 2019.

Për zbatimin e kësaj marrëveshje në tërësi është përgjegjëse Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore të KESH, sh.a, për periudhën 2018-2020.

- **Diskutimi në komision**

Komisioni për Politikën e Jashtme e shqyrtoi këtë projektligj, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 6 mars 2019.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të përfaqësues të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë. Të ftuarit shpjeguan qëllimin dhe përmbajtjen e projektligjit, detajet dhe të dhënat mbi marrëveshjen bazë dhe ndryshimet që propozohen në letërmarrëveshjen ndryshuese. Deputetët në komision pasi u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit ndalën dhe diskutuan mbi fazën e pestë të programit dhe mbi përfitimet që pritet të sjellë rialokimi i shumës brenda kategorive ekzistuese.

Anëtarët e Komisionit vlerësuan nismën e propozuar, kërkuar informacion mbi ecurinë e deritanishme të zbatimit të marrëveshjes dhe diskutuan lidhur me nevojën për përmbushjen e objektivave të këtij projekti brenda datës së riskeduluar, 31.12.2020.

- **Rekomandim për komisionin përgjegjës**

Për sa i takon **teknikës legjislative**, Komisioni vlerësoi se projektligji ka nevojë për një ndryshim. Konkretisht:

- Në nenin 2, fjala “vendim” të zëvendësohet me fjalën “ligj”.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

KRYETARE

MIMI KODHELI